

Lajme Ditore

Breaking News: Tërhiqet Thaçi, e pranon 1244 në fusnotë » Pas paqartësive disa-javore rreth përfaqësimit të Kosovës

[Home](#) [Lajme](#) [Ekonomi/Financa](#) [Sport](#) [Shkence / Teknologji](#) [Art & Zbavitje](#)

[Life & Style](#) [Lojra](#) [Opinion](#)

search...



Thursday, 23 February 2012

[Facebook](#) [Twitter](#)

BOOKING.COM online hotel reservations
FREE MEMBERSHIP
 Join now!

Investohen rreth 2 milionë në arsim të lartë

SUNDAY, 19 FEBRUARY 2012 00:00

0 COMMENTS

Share

Tweet 0

Një milion e 900 mijë euro do të jetë ndihma financiare që shteti austriak ka konfirmuar se do t'i investojë për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë publik në Kosovë.

... i i kapaciteteve menaxhuese në arsimin e lartë dhe sigurimi i cilësisë në këtë nivel të arsimit shkëpunimi me institucione të arsimit të lartë të ndryshme evropiane do të jenë në të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur jet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), mbështetur nga Ambasada Austriake në Kosovë.

Marrëveshja e nënshkruar kohë më parë do të pasohet me krijimin e një bordi udhëheqës, ku do të marrin pjesë përfaqësues të të dyja palëve, asaj austriake dhe kosovare, me të drejta të barabarta në udhëheqjen dhe zbatimin e marrëveshjes. Për të konstituar organet menaxhuese të projektit, javën e ardhshme pritet të mbahet një takim ndërmjet dy palëve.

Zëvendësministri i Arsimit, Nehat Mustafa, ka deklaruar për "Zërin" se përmes këtij projekti do të përfitojnë sidomos dy universitetet publike në vend. Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit, sipas Mustafës, do të jenë përfitues direkt të kësaj përkrahjeje që synon ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

"Përkrahja do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve edhe të MASHT-it dhe kushteve në dy universitetet". Ndërkohë një pjesë e këtyre mjeteve do të ndahet edhe për kërkime shkencore, ndërsa rëndësi e madhe do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me universitetet evropiane.

Mustafa ka theksuar se bashkëpunimi me universitetet evropiane do të përqendrohet në absorbimin e përvojave të universiteteve që do të kontaktohen.

Ndërkaq, ambasadori i Austrisë në Kosovë, Johann Brieger, gjatë një takimi me krerët e Ministrisë ka theksuar se Austria ka marrë përsipër të ndihmojë në përmirësimin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.


"Kjo mund të arrihet nëse kemi arsim cilësor, kushte të mira për sigurim të cilësisë dhe kuadro të afta menaxhuese", ka deklaruar ai.

Shuma financiare e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të mbulohet 90 për qind nga shteti austriak dhe 10 për qind nga Qeveria e Kosovës.

Projekti do të implementohet nga konzorciumi Austriak i udhëhequr nga WUS Austria. Dy partnerët tjerë të projektit janë ZSI dhe OEAD.

WORLD NEWS

Edit



LAJMET E FUNDIT

- Feb 19, 2012 Tërhiqet Thaçi, e pranon 1244 në fusnotë
- Feb 19, 2012 Katy Perry blenë Maserati
- Feb 19, 2012 Kërkon dëmshpërblim
- Feb 19, 2012 Murat Jashari: S'është kjo Kosova për të cilën u sakrifikuam
- Feb 19, 2012 Investohen rreth 2 milionë në arsim të lartë
- Feb 12, 2012 Ndërpritet mësimi në të gjitha shkollat edhe për një javë
- Feb 12, 2012 Shkon në 10 numri i viktimave të Restelicës
- Feb 12, 2012 VIDEO: Vdekja e Houston, dyshohet mbidozë
- Feb 12, 2012 Anatomia e gjumit: opsioni më i keq për trupin është shtyrja e alarmit...
- Feb 12, 2012 Kur gruaja do t'ia dërgonte faturën burrit?

POPULAR

- Banka Botërore lyp një vlerësim të ri ekonomik për projektin "Kosova e Re"
- Ciljeta: Shyqyr Zotit jam xham fare
- James Berisha mund të jetë kidnapuar ose arrestuar
- James Berisha, ende në burg diku në Eritre
- Dafina Zeqiri: Making Of "My Swag" /VIDEO/
- EULEX e donte "kokën" e Limajt
- Skillz - Dokna mire (Official Video 2011)
- Adelina Tahiri - seksi në plazh